

**VENDIM**  
**PËR SHPALLJEN E AMANDAMENTIT XIX TË KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË**  
**MAQEDONISË**

Shpallet amendamenti XIX i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilin e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më datë 26 dhjetor 2003.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 07-6601/1

26 dhjetor 2003

Shkup

KRYETAR

I KUVENDIT TE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË,

dr. Lupço Jordanovski

**AMENDAMENTI XIX I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe hyn në fuqi me ditën e shpalljes së tij.

**A M E N D A M E N T I X I X**

1. Garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit. Vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe të gjitha formave të tjera të komunikimit, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të pengimit ose zbulimit të veprave penale, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe të mbrojtjes së Republikës.

Ligji nxirret me shumicën e dy të tretave të votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 17 i Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.